



## QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

### KARTË – TEKNOLOGJIKE

#### TEKNOLOGJIA E KULTIVIMIT TË SHEGËS

##### **Ngritja e parcelës së Shegës**

Zgjedhja e vendit për mbjellje është hapi i parë dhe themelor për të pasur një bllok frutor sa më të mirë. Niveli i ujërave nëntokësore nuk duhet të jetë më pak se dy metra. Tokat argjilore të rënda që vijnë ngadalë, moçaloret, dhe tokat e kripura nuk janë të përshtatshme për këtë kulturë.

##### **Përgatitja e tokës**

Është procesi më i rëndësishëm, proces me të cilin fillon puna për ndërtimin e një pemëtoreje të re. Kështu, përgatitja e tokës për mbjellje fillon me prerjen, pastrimin nga shkurret, kërcunjtë, gurët dhe sistemimin e terrenit. Për të pasur një përgatitje sa më të mirë, tokës i bëhen këto punime: një punim i thellë (qilizëm), një diskim, një frezim në varësi të tipit të tokës dhe të kushteve në të cilat realizohen punimet. Toka është e mirë të ngrihet në formën e kurritzit të peshkut me gjerësi 120 cm dhe të mbulohet me plasmas rekomandohet i bardhë për arsye se: mban temperaturën e tokës dhe reflekton dritën duke i dhënë me shumë ngjyrë frutave sidomos atyre që ndodhen brenda kurorës.

##### **Sistemimi i tokës**

Duke shfrytëzuar mendimin e specialisteve përkatës behet piketimi sipas izoipseve: kur vendi ka pjerrësinë që kalon 25 %, toka tarracohet duke u kujdesur që çdo tarracë të ketë një pjerrësi nga ana e brendshme, për kullimin e ujrave në kanalën që do të hapet për këtë qëllim. Në terren me pjerrësi të madhe krijohen tarraca individuale me sheshe 2,5m x 3m. Kur nuk aplikohet sistemi i tarracimit, në tokën e caktuar për mbjellje behet sistemimi sipërfaqësor duke korrigjuar sopet apo gropat që shfaqen si dhe duke dhënë pjerrësinë e nevojshme. Pas kësaj duhet të hapen gropat për mbjellje sipas piketimit përkatës të cilat duhet të kenë përmasat 1m x 1m x 1m. Hapja e gropave duhet të kryhet disa muaj para mbjelljes.

Në sistemin e përgjithshëm të tokës bëjnë pjesë edhe përcaktimi i rrugëve ndërmjet ngastrave dhe i atyre që rrethojnë bllokun, dhe punimet e nevojshme të rrjetit ujitës, në rastet kur duhet dhe ekziston një mundësi e tillë.

##### **Përgatitjet për mbjellje**

Pasi zgjidhet toka dhe përgatitet si më lart, bëhet mbjellja e fidanëve. Për të patur blloqe të rregullta, mbjellja bëhet në disa forma (në varësi të relievit të tokës dhe kushteve të vendit). Kur toka ka qenë nën kulturë, përgatitja dhe mbjellja e shëgishtes bëhet në atë vit.


##### **Distancat e mbjelljes**

Largësitë e mbjelljes varen nga lloji i tokës, cilësitë e llojit që do të mbillet dhe kundrejtimi. Në toka fushore ose kodra me pjerrësi të buta, bimët mbillen me afër njëra tjetrës me rreshta të gjera, për lehtësimin e shërbimeve të mekanizuara. Në zonat e ngrohta në toka të pasura, nën ujë, përdoret largësia 6m x 3.5m (475 rrënjë për ha), 4m x 6m (416 rrënjë për ha) ose 3m x 5m (500 rrënjë për ha). Në sistemin katror, largësia më e mirë është 4m x 4m (625 rrënjë për ha). Piketimi

bëhet me punëtorë të specializuar, të cilët duhet të tregojnë kujdes për kanalet, rrugët, vijat ujëtare dhe brezat mbrojtës kundër erërave të forta. Piketimi mund të quhet pjesë përbërëse e formave të mbjelljes, sepse ndryshon sipas tyre.

### **Mbjellja e shegës**

Para mbjelljes, bëhet sigurimi i fidanëve me numër më të madh se janë llogaritur për njësinë e sipërfaqes, shtratifikohen llojet e caktuara pranë shegishtes, kontrollohen fidanat që të jenë brenda standardit (80cm - 120cm të gjatë, me 4 - 5 degëza, me tri rrënjë kryesore 25cm - 30 cm të gjata, të padëmtuara dhe me rrënjë të dyta e të treta, pa sëmundje e dëmtues),



**Figurë 1.** Mbjellja e fidanit të Shegës

### **Ujitja e shegës**

Ujitja e pemëve të shegës është shumë e rëndësishme, pasi një periudhë me mungesë lagështire e me rënien e një sasive rreshjesh në momentin e pjekjes së frutit në vjeshtë mund të ketë plasaritje të frutit. Edhe pse shegët janë shumë tolerante nga thatësira, duke siguruar lagështi të mjaftueshme të tokës do të rezultojë në një përmirësim të konsiderueshëm në energji bimore dhe do të parandalojë plasaritjen e frutave ujitjet rregullisht me një sasi të duhur të ujit.

Sasia e tepërt e ujit mund të shkaktojë dëmtimin e frutave.

Ujitja me pika është metodë e preferuar në pemishte me shegë, Kërkesat e shegës për ujë janë më të mëdha në periudhën e vegjetacionit janë rreth 600 mm në vit.

Pemët duhet të ujitën çdo 7-10 ditë në mungesë të reshjeve të konsiderueshme. Shegët janë tolerante dhe ndaj përmbytjeve.

### **Plehrimi i shegës**

Në shegë, sasia e rekomanduar për azot është 200-300 kg/ha /vit dhe përkalium (sulfate kalium) është 100-200 kg/ha/vit. Rreth 50-100 kg/ha/vit i fosforit.

Azoti aplikohet me fillimin e rritjes së kokrrës në gjithë periudhën e ujitjes deri në dy javë para vjeljes.

Aplikacionet e tepërta ose të vonuara të azotit mund të vonojnë pjekjen e frutave.

**Kaliumi;** aplikohet gjatë gjithë sezonit të ujitjes.

**Fosfori;** aplikohet në dy faza, e para në fillim të sezonit dhe e dyta në fund.

**Plehu i stallës;** është shumë i rëndësishëm për shegën. Në vitin e parë, 5-10 kg pleh stalle.

Në vitet e tjera sasia duhet të rritet 40-50kg pleh stalle.

Aplikimi bëhet në muajin Nëntor-Dhjetor.

**Plehrimi i gjelbër;** është gjithashtu efektivë në të ushqyerit e shegës. Mbjellja bëhet në muajt Tetor-Nëntor dhe më vonë duhet të bëhet përmbyjsja e tyre kur kanë lulëzuar në masën 25%.

### **Krasitja e shegës**

Pas vitit të parë në bimët e reja të shegës duhet të hiqen lastarët që hijezojnë njëri-tjetrin dhe bëhet rrallimi i tyre me qëllim ajrosjen e mirë dhe lejimin e hurjes së dritës në gjithë bimën. Në vitet e para duhet të kihet parasysh jo eliminimin e një mase më të madhe pasi bima është akoma e re.

### **Rrallimi i frutave të shegës**

Është një moment delikat që ka lidhje me cilësinë e prodhimit. Lënia e një ngarkese të madhe të gjithë frutave të lidhur në bimë do të ketë pasoja, si rrjedhojë pesha do të jetë e vogël dhe fruti do të humbasë cilësinë e tij. Rrallimi duhet të bëhet në momentin kur frutat kanë arritur një madhësi mbi 5mm duke ruajtur një raport të numrit të frutave në çdo degë.

## **KULTIVARËT E VENDIT TË SHEGËS**

### **DEVEDISHE**

Gjen një përhapje të gjerë në të gjithë territorin e vendit në saj të përshtatshmërisë që ka fituar. Është bimë shkurrore, me rritje mesatarisht të fuqishme. Fruti shumë i madh, me formë të rrumbullakët, me cipë mesatarisht të hollë, me ngjyrë të kuqe e cila nga ana e diellit errësohet Kokrrat janë me ngjyrë të kuqe me lëng dhe të ëmbla. Farëzat janë të vogla. Prodhueshmëria e lartë dhe e përvitshme. Ruhet për rreth 6-8 muaj

### **TIVARESHE**

Kultivar me origjinë nga Tivari por që është kultivuar për një kohë të gjatë në vendin tonë. Është bimë shkurrore, me rritje të fuqishme, arrin në rreth 4m lartësi. Fruti është me madhësi mesatare, me ngjyrë të kuqe në të verdhë.

Kokrrat janë me madhësi mesatare, me ngjyrë të kuqe, plot lëng dhe të ëmbla

Prodhimi i lartë. Ruhet për rreth 6 muaj.

### **BAÇALLEK**

Kultivar autokton i përhapur në rrethin e Shkodrës. Pema shkurrore me rritje mesatare.

Fruti mesatar, me lëkurë mesatarisht të hollë dhe të lëmuar, me ngjyrë të verdhë dhe të kuqe nga ana e diellit. Kokrrat janë me madhësi mesatare, me ngjyrë të kuqe me shije majoshe dhe të lëngshme. Prodhueshmëria e lartë dhe e qëndrueshme.

## **KULTIVARËT E HUAJ TË SHEGËS**

### **WONDERFUL**

Është një kultivar i rëndësishëm amerikan dhe është kultivuar në

shumë vende. Fruti është shumë i madh dhe ka lëkurë të kuqe. Mishi është i pasur, ngjyrë të kuqe, lëng me shije të mprehtë. Shegë e mrekullueshme rritet edhe në toka alkaline ku shumica e bimëve nuk mbijetojnë. Kjo piqet në shtator-tetor

### **HICAZNAR**

Me origjinë turke. Në botë është një nga më të rëndësishme

Fruti i freskët ka fara e butë dhe cipa ka ngjyre të errët të kuqe. shija e saj është e embel ne majoshe. Ngjyra e fruta është e kuqe dhe trashësi lëvorje është rreth 3.3 mm.

Frutat ruhen deri në 6 muaj. Periudha e vjeljes së kultivarit Hicaznar fillon nga fillimi i tetorit dhe periudha e vazhdon deri në fund të tetorit.

Prodhon më shumë se 40 kg fruta për bimë në një vit. Pragu për mot të ftohtë është -10°C dhe bimët e reja janë të prekura në këtë temperaturë.

### **HICRANNAR**

Është një kultivar i rëndësishëm i Turqisë dhe është e njohur si cv. me pjekje të hershme

Periudha e vjeljes fillon fundin e shtatorit dhe vazhdon së bashku me të gjithë Tetori. Frutat e freskët kanë fara të butë, cipat e kuqe dhe shija e saj është e ëmbël.

Prodhimi për bimë është më i vogël se sa Hicaznar. Pragu i saj i rezistencës ndaj të ftohtit është i njëjtë me Hicaznar

### **YMAZGAR**

Është një shëgë e hershme dhe vilet në mes të datave të 13-15 shtator. dallimet e saj kryesore nga kultivari të dy Hicrannar dhe Hicaznar janë se ajo ka fruta të mëdha, veshje të trashë dhe shije majoshe në të ëmbël

### **SËMUNDJET E SHEGËS**

#### **Alternaria**

Infeksioni i kësaj sëmundjeje prek bimen në fazën e lulëzimit,

Në fruta të vegjël e të sapoformuar vendoset infeksioni i cili zhvendoset në zgavrën qendror të frutave duke e shkatërruar pjesërisht ose tërësisht, ndërsa lëkura e jashtme mbetet normale.

Kontrolli i kësaj sëmundjeje duhet të jetë para-lulëzimit dhe pas lulëzimit duke bërë trajtimet me fungicide si; Cimoxamil 0.4%, Pastë bordolezë 0.7%, Mancizeb 0.2-0.3%.

#### **AspergillusFruit Rot (*Aspergillus niger*)**

Sëmundja prek bimën afër periudhës së pjekjes së frutave. Është problem rëndësishëm në shëgët që përdoren për ruajtje. Simptomat e parë të sëmundjes shfaqen në formën e një rrethi me ngjyrë të hapur e cila gradualisht bëhet kafe. Në fazat e avancuara të sëmundjes një pjesë e madhe e frutit është i përfshirë duke i dhënë pamjen e një fruti të kalbur dhe me shije të thartë.

Në simptomat e brendshme të frutave, në qoftë se presim frutin brenda është e mbuluar me kërpudhat ngjyrë të errët .

#### **Botrytis, Penicillium dhe Trichoderma Fruta Rots**

Mold Gray (*Botrytis cinerea*) rot, Mold gjelbër (*Penicillium digitatum*) kalbëzimi dhe Trichoderma janë sëmundjet kryesore pas vjeljes së frutave të shëgës.

Shenjat fillojnë të shfaqen në sipërfaqe të frutit dhe kur përparon, lëkura bëhet ngjyrë kafe dhe lëkura mbetet e ashpër.

### **DËMTUESIT E SHEGËS**

**Aphids:** Janë ndër dëmtuesit më të përhapura dhe serioze në pemishte me shëgë, por ata janë shpesh mjaft të kontrolluara nga armiqtë natyrore.

*Aphis punicae Passerini*, ushqyhet në sipërfaqen e sipërme të gjetheve të shëgës. *Aphis punicae* shkakton dëmtimin në lule, fruta e cila rezulton në humbje të cilësisë së frutit dhe ulja e rendimentit.

#### **Ceratitis capitata Wied**

Ky insekt është i njohur në mbi 260 lloje të pemëve dhe perimeve. Dëmi më i madh është në kultivarët e ëmbël të shëgës. Është rekomanduar spërkatje në fillim të formimit të frutave.

### **MASAT E LUFTIMIT**

Dimetoat 0.1%, Vaj mineral i bardhë 1.5%, Confidor 005-0075%, Nurrelle D 0.1-0.15%.

Plasaritja e Frutit është problemi kryesor në cilësisë e shegës. Është një çrregullim fiziologjik që ndodh për shkak të normave të ndryshme të rritjes midis lëkures dhe mishit të frutave. Ka shumë shkaqe për plasaritje të frutave në shegë.

**Shkaqet e plasaritjeve së frutave në shegë mund të jenë si më poshtë:**

1. Faktorët gjenetik
2. Koha e vjeljes
3. Ujitjet e parregullta në kohën e rritjes së frutit
4. Klima
7. Teprica e ujit në kohën e pjekjes
8. Pabarazitë e të ushqyerit të bimëve

**Masat e mëposhtme mund të merren për kontrollin e plasaritjes në fruta:**

1. Duke përdorur kultivar tolerantë
2. Ujitje të rregullt të shoqëruara me plehra të kombinuara
3. Duke përdorur kultivar të hershëm
4. Përdorimi i bimëve strehë kundër erës
5. Trajtimi kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve

Specialist:

Athina Llambro